

KËRKESË
Nr. 607, datë 3.3.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“ARMAND KOLLOBANI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH-VL-2019 002028-5, datë 20.8.2019, për subjektin Armand Kollobani “EMPA Hospitality”, me adresë: rruga “Butrinti”, zona kadastrale 8642, Sarandë.

KRYEINSPEKTOR
Lorenc Rexho

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-VL-2019-002028-5

Datë 20.8.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-002028-2, datë 20.8.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “EMPA Hospitality”, NIPT L94010802E, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Armand Kollobani”, prej datës 30.7.2019 deri në datën 30.7.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 20.8.2019 dhe e njoftoi në datën 20.8.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji. nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar” (i ndryshuar), 12.

Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar” (i ndryshuar), 21.

Ligji. nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar” (i ndryshuar), 13/a.

Ligji nr. 15/2016, datë 10.3.2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, 6.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Paralajmërim

2. Dënim administrativ plotësues:

Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, neni 48, pika 6, “Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar shoqërohet me dënim plotësues ‘gjobë’ me vlerën 50 000.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

9.9.2019 – Të pajiset me akt miratimi higjieno-sanitar.

9.9.2019 – Të pajiset personeli me librezë shëndetësore.

9.9.2019 – Të pajiset personeli me raport mjekoligjor KML.

9.9.2019 – Të pajiset me certifikatën DDD dhe me raportanalizën e ujit të depozitës.

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. -

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Elona Mano

ID_



Arqile Kaishi

ID_




Pavjola Zeneli

ID_0412080008

Personi i autorizuar i subjektit:

Armand Kollobani

Armand
Kollobani


Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “EMPA Hospitality” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.